



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 103

Tiranë – E mërkurë, 10 maj 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe	
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 37, datë 25.4.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimeve nr. 1, datë 16.1.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë; nr. 45, datë 2.7.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2014-1941-175, datë 16.7.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.....	5699
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 38, datë 25.4.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 196, datë 16.2.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.....	5708
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 39, datë 5.5.2017	Me objekt shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr. 2779, datë 7.4.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr. 2088, datë 13.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; 00-2014-3005, datë 6.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.....	5712



VENDIM
Nr. 37, datë 25.4.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 02.02.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 90/26 Akti, që i përket:

KËRKUES: Endrit Dokle

SUBJEKT I INTERESUAR: Prokuroria e Përgjithshme

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr.1, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë; nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda; nr. 00-2014-1941-175, datë 16.07.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 17, 18, 30, 31, 32, 42, 131/f, 132/1, 134/1/i dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i KEDNJ-së, nenet 27, 28, 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Besnik Imeraj, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit Endrit Dokle, që kërkonte pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që kërkonte rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuarisi Endrit Dokle është akuzuar nga organi i prokurorisë për veprat penale “Pjesëmarrje në grupe të strukturuar kriminale”, “Vrasje me paramendim” etj. Kërkuarisi është dënuar me

burgim të përjetshëm nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm dhe aktualisht është duke vuajtur dënimin e tij për kryerjen e disa veprave penale në procesin e quajtur “Banda e Durrësit”.

2. Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me vendimin nr.1, datë 16.01.2012, ka vendosur të deklarojë fajtor të pandehurin Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Krijimi dhe drejtimi i grupit të strukturuar kriminal”, të parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i parë i Kodit Penal, e në bazë të këtij neni dënimin e tij me 8 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit Dritan Disha, ndodhur në datën 09.07.2000, sipas neneve 78/2-25 dhe neni 51 të Kodit Penal (KP), dhe dënimin e tij me 12 vjet e 6 muaj burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit Erion Lame, ndodhur në datën 14.01.2002, sipas neneve 78/2-25 të KP-së, dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të pandehurit Lulëzim Berisha, ndodhur në datën 05.04.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së, dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 22 vjet burgim. Meqenëse vepra penale është kryer në kuadër të “grupit të strukturuar kriminal”, në aplikim të neni 334, paragrafi i parë, të KP-së, gjykata ka vendosur dënimin e tij për këtë veprë penale me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të pandehurit Lulëzim Berisha, ndodhur në datën 05.05.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së, dhe në bazë të këtyre neneve, dënimin e tij me 25 vjet burgim. Meqenëse vepra penale është kryer në kuadër të “Grupit të strukturuar kriminal”, në aplikim të neni 334, paragrafi i parë, të Kodit Penal, gjykata ka vendosur dënimin e tij për këtë veprë penale me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të pandehurit Lulëzim Berisha, ndodhur në muajin gusht të vitit 2005, sipas neneve



78/2-22 të KP-së, dhe në bazë të këtyre neneve, dënimin e tij me 21 vjet burgim. Meqenëse vepra penale është kryer në kuadër të “Grupit të strukturuar kriminal”, në aplikim të nenit 334, paragrafi i parë, të Kodit Penal, gjykata ka vendosur dënimin e tij për këtë veprë penale me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të pandehurit Lulëzim Berisha, ndodhur në datën 30.08.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP, dhe në bazë të këtyre neneve dënimin e tij me 22 vjet burgim. Meqenëse vepra penale është kryer në kuadër të “Grupit të strukturuar kriminal”, në aplikim të nenit 334 paragrafi i parë, të KP-së, gjykata ka vendosur dënimin e tij për këtë veprë penale, me 25 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, në dëm të shtetasit Avni Gashi, ndodhur në datën 12.05.2005, parashikuar nga nenet 78/2-25 të KP-së, e në bazë të këtyre neneve, dënimin e tij me burgim të përjetshëm. Meqenëse vepra penale është kryer në kuadër të “Grupit të strukturuar kriminal”, edhe në aplikim të nenit 334, paragrafi i parë, të KP-së, gjykata ka vendosur dënimin e tij për këtë veprë penale me burgim të përjetshëm. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Rrëmbimi ose mbajtja peng e personit”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga nenet 109/1 dhe 25 të KP-së, e në bazë të këtyre neneve, dënimin e tij me 14 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Moskallëzim të krimi”, parashikuar nga neni 300 i KP-së, e në bazë të këtij neni dënimin e tij me 3 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, parashikuar nga neni 278/2 i KP-së, e në bazë të këtij neni dënimin e tij me 6 vjet burgim. Deklarimin fajtor të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 278/4 i KP-së, e në bazë të këtij neni dënimin e tij me 6 vjet burgim. Meqenëse vepra penale është kryer në kuadër të “Grupit të strukturuar kriminal”, në aplikim të nenit 334, paragrafi i parë, të KP-së, gjykata ka vendosur

dënimin e të pandehurit Endrit Dokle për këtë veprë penale me 11 vjet burgim. Deklarimin të pafajshëm të të pandehurit Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të shtetasve Isuf Morina dhe Kujtim Haxhijaj, ndodhur në datën 05.05.2005, parashikuar nga nenet 79/dh-25-22 të KP-së, në bazë të neneve 377 dhe 388/d të KP-së, për arsye se u tërhoq akuza dhe nuk provohet të ketë kryer këtë veprë penale. Urdhërohet kthimi i akteve Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë në lidhje me veprën penale “Trafikimi i armëve dhe municioneve”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 278/a/2 i KP-së, në ngarkim të të pandehurit Endrit Dokle, sipas nenit 377 të KPP-së, sepse u tërhoq kjo akuzë nga prokuroria. Përfundimisht, në aplikim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, gjykata ka vendosur dënimin e të pandehurit Endrit Dokle me burgim të përjetshëm. Vuajtja e dënimit për të pandehurin Endrit Dokle fillon nga data e ndalimit të tij, 02.11.2005, dhe kryhet në një burg të sigurisë së lartë.

3. Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, me vendimin nr.45, datë 02.07.2012, ka vendosur të lërë në fuqi vendimin nr.1, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

4. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.167, datë 16.07.2014, ka vendosur prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për të gjykuarin Endrit Dokle për veprën penale “Krijimi dhe drejtimi i grupit të strukturuar kriminal”, parashikuar nga neni 333/a, paragrafi i parë, i KP-së.

Ndryshimin e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, duke e deklaruar fajtor të gjykuarin Endrit Dokle për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, në bashkëpunim, në dëm të shtetasit Dritan Disha, ndodhur në datën 09.07.2000, parashikuar nga nenet 78/1-25 të KP-së, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.01.1995 sipas formulimit të ligjit të kohës kur është kryer vepra penale dhe në bazë të këtij



neni dhe nenit 51 të KP, dënimin e tij me 12 vjet e 6 muaj burgim. Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sa i përket deklarimit fajtor të të gjykuarit Endrit Dokle, llojit dhe masës së dënimit; për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të gjykuarit Lulëzim Berisha, ndodhur në datën 05.04.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së. Prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për sa i përket kryerjes së kësaj vepre në kuadër të grupit të strukturuar kriminal (sipas pikës 4.2 të këtij vendimi), parashikuar nga neni 334 paragrafi i parë i KP-së. Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sa i përket deklarimit fajtor të të gjykuarit Endrit Dokle, llojit dhe masës së dënimit, për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të gjykuarit Lulëzim Berisha, ndodhur në datën 05.05.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së. Prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për sa i përket kryerjes së kësaj vepre (sipas pikës 4.4 të këtij vendimi) në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 334, paragrafi i parë i KP-së. Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sa i përket deklarimit fajtor të të gjykuarit Endrit Dokle, llojit dhe masës së dënimit, për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të gjykuarit Lulëzim Berisha, ndodhur në muajin gusht të vitit 2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së. Prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë

16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për sa i përket kryerjes së kësaj vepre (sipas pikës 4.6 të këtij vendimi) në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 334 paragrafi i parë i KP-së. Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sa i përket deklarimit fajtor të të gjykuarit Endrit Dokle, llojit dhe masës së dënimit, për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të të gjykuarit Lulëzim Berisha, ndodhur në datën 30.08.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së. Prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për sa i përket kryerjes së kësaj vepre (sipas pikës 4.8 të këtij vendimi), në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga N.334, paragrafi i parë i KP-së. Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sa i përket deklarimit fajtor të të gjykuarit Endrit Dokle, llojit dhe masës së dënimit, për kryerjen e veprës penale “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë, në dëm të shtetasit Avni Gashi, ndodhur në datën 12.05.2005, sipas neneve 78/2-22 të KP-së. Prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për sa i përket kryerjes së kësaj vepre (sipas pikës 4.10 të këtij vendimi) në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 334, paragrafi i parë i KP-së. Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë për sa i përket deklarimit fajtor të të gjykuarit Endrit Dokle, llojit dhe masës së dënimit, për kryerjen e veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, më shumë se një herë, parashikuar nga neni 278/4 i KP-së.



Prishjen e vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë dhe të vendimit nr.01, datë 16.01.2012 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, si dhe pushimin e çështjes për sa i përket kryerjes së kësaj veprë (sipas pikës 4.12 të vendimit) në kuadër të grupit të strukturuar kriminal, parashikuar nga neni 334, paragrafi i parë i KP-së.

Lënien në fuqi të vendimit nr.45, datë 02.07.2012 të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda Tiranë në lidhje me disponimet për akuzat e tjera për të gjykuarin Endrit Dokle. Përfundimisht, pas ndryshimit të pjesshëm të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, në aplikim të nenit 55 të KP-së, në bashkim të dënimeve, gjykata ka vendosur dënimin e të gjykuarit Endrit Dokle me burgim të përjetshëm.

II

5. **Kërkuesi Endrit Dokle** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

6. *Është cenuar parimi i gjykatës së caktuar me ligj.*

6.1 Gjykata e Lartë, edhe pse ka konstatuar se provat dhe faktet nuk përputheshin me njëra-tjetrën, nuk ka arritur në përfundimin e prishjes së vendimeve të Gjykatës së Shkallës Parë për Krimet e Rënda dhe të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, vetëm për këtë shkak. Përkundrazi, Gjykata e Lartë ka marrë përsipër, në gjykimin në këtë shkallë, të bëjë ndreqjen e gabimeve të gjykatave të faktit, duke e bërë vetë ajo këtë ndreqje në vendimin e saj.

6.2 Gjykata e Lartë është gjykatë e ligjit dhe juridiksioni i saj fillestar është i kufizuar dhe kjo gjykatë shqyrton si gjykatë e shkallës së parë ato vepra penale të kryera nga ato subjekte që përcakton neni 75/b/2 i KPP-së.

7. *Është cenuar parimi i paanshmërisë së gjykatës.*

7.1 Gjyqtarja F.H. ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar në shkallë të parë këtë çështje, ka dhënë një vendim, me të cilin ka vleftësuar dhe caktuar masë sigurimi “arrest në burg”, nën dyshimin e arsyeshëm se ky shtetas ka kryer veprën penale të trafikimit të narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a/2 i KP-së.

7.2 Ndërkohë që ka dhënë këtë vendim gjyqësor si gjyqtare e vetme, zhvillohej edhe gjykimi i Faqe | 5702

themelit për të gjykuarin Endrit Dokle për akuzat e tjera që janë objekt i kësaj kërkesë, si pjesëtare e këtij trupi gjykues.

7.3 Pjesëmarrja e kësaj gjyqtareje është bërë në kushtet e papajtueshmërisë për shkak të pjesëmarrjes së saj në gjykimin me objekt vleftësimin dhe caktimin e masës së sigurimit për të gjykuarin Endrit Dokle. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë, si dhe vendimet e Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda Tiranë dhe Gjykatës së Lartë, që kanë lënë në fuqi atë vendim, janë të pavlefshme në kuptim të nenit 128/1-a të KPP-së.

8. *Është cenuar standardi i arsytimit të vendimit gjyqësor.*

8.1 Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka konstatuar se gjykatat e faktit nuk kanë bërë një analizë në mënyrë të detajuar të të gjitha akteve dhe provave të shqyrtuara, për secilin të gjykuar, për secilën veprë penale, për të cilat i kanë deklaruar ata fajtorë, por i kanë analizuar aktet dhe provat duke iu referuar në mënyrë të veçantë çdo ngjarjeje kriminale, ku kanë marrë pjesë, sipas rastit, të gjykuarit.

8.2 Vendimet e gjykatave të faktit nuk janë logjike, nuk të respektojnë të gjitha elementet e përcaktuara nga jurisprudenca kushtetuese për garantimin e parimit të arsytimit të vendimit gjyqësor, sipas parimeve të cituara më lart. Vendimet e gjykatave të faktit janë konfuzë për faktet dhe rrethanat e deklarimit të fajësisë së kërkuesit.

9. *Është cenuar parimi i mosdeklarimit fajtor dhe të mosdënimit mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme, sanksionuar nga neni 32/2 i Kushtetutës.*

9.1 Gjykatat në këtë çështje e kanë bazuar të gjithë argumentimin e fajësisë për të gjykuarin Dokle etj. mbi deklaratimet e të gjykuarit Adriatik Coli, me statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë, dhe ato mund të përdoren si e vetmja provë në procesin gjyqësor që zhvillohej kundër të pandehurve të tjerë, pa qenë të shoqëruara me elemente të tjera provuese, pra me prova të tjera shkresore, me dëshmitarë apo edhe me deklarime nga të pandehur të tjerë.

10. *Gjykimi i çështjes nuk është bërë brenda një afati të arsyeshëm të parashikuar në nenin 42/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.*



10.1 Nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave rezulton se kjo çështje ka qenë në gjykim në shkallë të parë nga data 17.06.2007 (data e ardhjes së çështjes për gjykim) deri në datën 16.01.2012 (datë në të cilën është dhënë vendimi përfundimtar). Pavarësisht se çështja ka qenë në ngarkim të disa të pandehurve, një afat 5-vjeçar për gjykimin në shkallë të parë nuk është nga ato që mund të quhen të përshtatshme dhe të arsyeshme nën dritën e jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës vërehet se kërkuesi ka shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Në rastin në shqyrtim disa seanca janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues. Për këto arsye është edhe sjellja e këtyre autoriteteve që ka passjell vonesa në shqyrtimin e saj.

11. Është cenuar parimi i barazisë së armëve.

11.1 Në këtë gjykim nuk është respektuar e drejta e të gjykuarit Endrit Dokle dhe mbrojtësve të tij për t'u njohur me të gjitha aktet e hetimit paraprak në momentin e përfundimit të hetimeve. Prokurorët kanë paraqitur në gjykim në momentin e parashtrimit hyrës dhe kërkesës për prova, prova dhe akte të panjohura nga i gjykuari dhe mbrojtja. Ky fakt është i pranuar në konstatimet që bën Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes. Në faqen 408 të vendimit të Gjykatës së Lartë thuhet: “Në gjykimin në shkallë të parë, ndonëse të gjykuarit dhe mbrojtësit e tyre kanë nënshkruar procesverbalin për njohjen me aktet e hetimit paraprak, mbi pretendimin e mbrojtësve gjykata ka urdhëruar përfaqësuesit e akuzës që të njohin mbrojtësit edhe me akte të fashikullit të prokurorit që nuk janë pjesë e fashikullit të gjykimit”. Ky fakt bën që në gjykimin e shtetasit Endrit Dokle të mos jetë respektuar parimi i barazisë së palëve në gjykim, për pasojë ky proces është i paligjshëm dhe antikushtetues.

12. Është cenuar e drejta e mbrojtjes.

12.1 Gjykatat pa të drejtë e kanë kufizuar maksimalisht të drejtën e të gjykuarit Dokle për t'u mbrojtur, pasi nga ana e tyre është kërkuar që të paraqesin prova për ndikimin e politikës dhe të politikanëve të caktuar në gjykimin e kësaj çështjeje, pikërisht për këtë të gjykuar. Të tilla prova, që janë refuzuar nga gjykata, të kërkuara nga mbrojtja dhe që provonin këtë pretendim, janë deklarime të

politikanëve dhe artikuj të mediave të ndryshme, siç përmenden konkretisht me emra gjatë gjykimit. Të gjykuarit Endrit Dokle dhe mbrojtësve të tij nuk u është realizuar e drejta që buron nga kërkesat e neneve 39 dhe 34 të KPP-së. Kjo ka bërë që ata të jenë vënë në pozitë të pamundur për të realizuar mbrojtjen në fazën e hetimeve paraprake.

12.2 Në ditën e përfundimit të hetimeve (pa u pyetur asnjëherë më parë), atij i është komunikuar një akuze e re, ajo e parashikuar nga nenet 109/1 e 25 të KP-së “rreëmbimi ose mbajtja peng e personit”. Në këtë mënyrë nuk i është dhënë koha e nevojshme për t'u njohur me provat dhe për t'u mbrojtur për këtë akuze dhe për më tepër për të realizuar të drejtën për të paraqitur prova.

13. Është cenuar parimi i prezumimit të pafajësisë

13.1 Gjykatat e kanë gjykuar çështjen me paragjykimin se i pandehuri e ka kryer krimin për të cilin akuzohet, duke u bazuar në prova që nuk janë në përputhje me ligjin.

14. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, pretendon se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi nuk përmban asnjë element të cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, duke parashtruar si vijon:

14.1 Nuk qëndron pretendimi për cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj. Kolegji Penal ka vlerësuar se fajësia në ngarkim të tij është e provuar pa asnjë dyshim.

14.2 Nuk qëndron as pretendimi për mbledhje provash në mënyrë të paligjshme. Ndryshe nga sa pretendon kërkuesi, organi i prokurorisë për krime të rënda ka pasur tagrat e nevojshëm për të marrë nga i penduari deklarime të nevojshme për hetimin. Edhe verifikimi i thënieve në vend nuk është përdorur si provë në vetvete.

14.3 Nuk qëndron as pretendimi për cenimin e parimit të barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor. Rezulton se në të gjitha shkallët e gjykimit kërkuessit, nëpërmjet mbrojtësit të tij, i është dhënë mundësia për t'u njohur apo për të dhënë argumentet e veta gjatë shqyrtimit gjyqësor.

14.4 Nuk qëndron pretendimi lidhur me cenimin e parimit të paanshmërisë së gjykatës. Në rastin konkret gjyqtarja F.H. ka dhënë një masë sigurimi për të pandehurin, por që nuk ka lidhje me të njëjtin procedim objekt shqyrtimi.

14.5 Nuk qëndron pretendimi për gjykimin brenda një afati të arsyeshëm. Nga shqyrtimi i materialeve të paraqitura është i kuptueshëm



kompleksiteti i procesit gjyqësor në fjalë, duke pasur parasysh numrin e të pandehurve dhe të akuzave të veçanta për secilin. Gjatë gjykimit në shkallë të parë rezultoi se një pjesë e konsiderueshme e seancave gjyqësore nuk janë zhvilluar ose janë ndërprerë për shkak të mosparaqitjes, largimit të një apo më shumë mbrojtësve apo dhe për kërkesa të konsideruara si të padrejta nga gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesës

15. Përpara se të shprehet për thelbin e pretendimeve të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese (*Gjykata*) vlerëson të ndalet paraprakisht në vlerësimin e legjitimitimit të kërkesës për pretendimet e ngritura në kërkesë.

16. Kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 2-vjeçar të parashikuar në nenin 30/2 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

17. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* vërehet se kërkuesi ka ngritur pretendime, të cilat *prima facie* lidhen me të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor. Në vijim janë shqyrtuar sipas radhës së mësipërme pretendimet e kërkesës.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të Gjykatës së caktuar me ligj

18. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë ka cenuar parimin e gjykatës së caktuar me ligj, pasi Gjykata e Lartë ka marrë përsipër, në gjykimin në këtë shkallë, të bëjë ndreqjen e gabimeve të gjykatave të faktit, duke e bërë vetë ajo këtë ndreqje në vendimin e saj.

19. Shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*” është një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së. Ky element karakterizohet, në kuptimin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E drejta e çdo pale për t’u dëgjuar në seancë

përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t’i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimet nr.32, datë 25.05.2015; nr.40, datë 25.06.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Sipas jurisprudencës kushtetuese procesi nuk konsiderohet i parregullt, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, kur Kolegji i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova e fakte të vlerësuara në gjykimet e mëparshme, vendos të prishë vendimet dhe ta zgjidhë vetë çështjen, për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit. Në ushtrimin e funksionit të saj si gjykatë e ligjit, Gjykata e Lartë mund të vendosë për themelin e çështjes vetëm nëse mosmarrëveshja mund të zgjidhet në bazë të të njëjtave fakte e prova të vlerësuara nga gjyqtari i faktit dhe që përbëjnë bazën e vendimit në të cilin është bërë një interpretim i gabuar i ligjit. Kontrolli i saj duhet të fokusohet vetëm në drejtim të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Gjykata e Lartë nuk mund të anashkalojë apo të lërë pa vlerë prova që janë shqyrtuar dhe vlerësuar nga gjykatat e faktit, si dhe nuk mund të pranojë prova të cilat nuk janë administruar në gjykimin në fakt (*shih vendimin nr. 83, datë 30.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Gjykata vëren se në rastin konkret Kolegji Penal ka konkluduar se vendimet e gjykatave të faktit në lidhje me kërkuenin Endrit Dokle, i cili ishte deklaruar fajtor nga ato për kryerjen e veprës penale të “Krijimit dhe pjesëmarrjes në grupin e strukturuar kriminal”, do të prishen dhe çështja do të pushohet për shkak të zbatimit të gabuar të ligjit penal nga ana e këtyre gjykatave.

22. Gjykata vlerëson se ndryshe nga sa pretendohet nga kërkuesi në çështjen objekt shqyrtimi, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në lidhje me çështjen e fajësisë apo pafajësisë të kërkuenis Endrit Dokle ka konkluduar: “*Duke u bërë një analizë juridike të gjitha akteve dhe provave të mësipërme, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë konkludon se, thëniet e të gjykuarit Dritan Coli, edhe në lidhje me ngjarjet kriminale, për sa i përket të gjykuarit Endrit Dokle, janë në harmoni të plotë me prova të tjera, direkte dhe indirekte dhe në këto kushte, fajësia e të gjykuarit Endrit Dokle, në kryerjen e kësaj vepre penale, është e provuar në gjykim, jashtë çdo dyshimi të arsyeshëm*”.



23. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë si gjykatë ligji është shprehur dhe ka vepruar brenda kompetencave që i njihen me ligj. Kontrolli i saj është fokusuar vetëm në drejtëm të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankimuara, pra për mënyrën e zbatimit të ligjit nga gjykatat më të ulëta. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit në lidhje me cenimin e parimit të gjykatës së caktuar me ligj nuk është i bazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë së gjykatës

24. Kërkuari pretendon se gjyqtarja F.H., që ka qenë pjesë e trupit gjykues, që ka gjykuar në shkallë të parë këtë çështje, ka dhënë një vendim ndaj të gjykuarit Endrit Dokle, me të cilin ka vleftësuar dhe caktuar masë sigurimi “arrest në burg”, nën dyshimin e arsyeshem se ky shtetas ka kryer veprën penale të trafikimit të narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a/2 i KP-së.

25. Gjykata ka theksuar se gjykimi nga një gjykatë e paanshme është një nga elementet e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor, i garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së. Parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjykimave nga gjyqtarët për çështjen e shtruar përpara tyre. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. E drejta për t'u gjykuar përpara një gjykate kompetente, të pavarur dhe të paanshme, të caktuar me ligj, kërkon që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo, gjithashtu, duhet të shikohet që bëhet (*shih vendimin nr.11, datë 03.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Në kuptim të nenit 42/2 të Kushtetutës, respektimi i këtij parimi duhet të verifikohet duke zbatuar dy teste: testin subjektiv, i cili në thelb kërkon të provuarit e faktit se bindja personale e një gjyqtari ka ndikuar në vendimin e gjykatës dhe, gjithashtu, testin objektiv, i cili kërkon të provuarit nëse gjyqtari ka ofruar garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim të arsyeshem në këtë drejtëm. Në kuptim të testit subjektiv, paanshmëria e gjyqtarëve duhet të prezumohet derisa të provohet e kundërta. Për sa i përket testit objektiv, ai nënkupton se veç sjelljes personale të çdo anëtarit të trupit gjykues, duhet të provohet nëse ka fakte bindëse, të cilat vënë në dyshim paanshmërinë. Në këtë kuadër edhe dukja e jashtme ka rëndësi. Për rrjedhojë, kur vlerësohet nëse në një çështje konkrete ka një arsye të përligjur që rrezikon paanshmërinë e një trupi gjykues,

këndvështrimi i atyre që paraqesin këtë pretendim ka rëndësi, por vendimtar mbetet përcaktimi nëse ky dyshim është objektivisht i justifikueshem (*shih vendimin nr.11, datë 03.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Jurisprudenca e Gjykatës ka evidentuar se parimi i paanshmërisë në gjykim, në këndvështrim të përbërjes së trupit gjykues, duhet të respektohet në çdo shkallë të gjykimit. Për Gjykatën është konsideruar e njëanshme gjykata që nuk jep garancitë e nevojshme për një gjykim të paanshem në këndvështrimin objektiv. Dyshimi për paanshmërinë e gjyqtarit mund të ngrihet nëse gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt (*shih vendimin nr.11, datë 03.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Në rastin konkret, Gjykata konstaton se është i vërtetë fakti se gjyqtarja F.H. ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka gjykuar në shkallë të parë këtë çështje dhe ka dhënë një vendim, me të cilin ka vleftësuar dhe caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”, nën dyshimin e arsyeshem se ky shtetas ka kryer veprën penale të trafikimit të narkotikëve, parashikuar nga neni 283/a/2 i KP-së. Ky vendim mban nr.82, datë 09.05.2010 dhe është një procedim i ndarë nga procedimi që u gjykua nga kjo trupë gjyqësore. Duke qenë procedim i ndarë, Gjykata vlerëson se nuk është shkak paanshmërie, pasi sipas nenit 15/2 të KPP-së “*nuk mund të marrë pjesë në gjykim gjyqtari që ka vleftësuar masën e sigurimit ose çdo kërkesë tjetër të prokurorit të paraqitur gjatë hetimit paraprak në të njëjtin procedim*”.

28. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se ky pretendim është haptazi i pabazuar dhe nuk duhet të pranohet.

C. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

29. Kërkuari pretendon se në këtë gjykim nuk është respektuar e drejta e të gjykuarit Endrit Dokle dhe mbrojtësve të tij për t'u njohur me të gjitha aktet e hetimit paraprak në momentin e përfundimit të hetimeve. Prokurorët kanë paraqitur në gjykim në momentin e parashtrimit hyrës dhe kërkesës për prova, prova dhe akte të panjohura nga i gjykuari dhe mbrojtja. Në këtë mënyrë nuk është dhënë koha e nevojshme për për t'u njohur dhe t'u mbrojtur me provat për këtë akuze dhe për më tepër për të realizuar të drejtën për të paraqitur prova. Po ashtu, kërkuari pretendon se gjykatat e kanë bazuar fajësinë në ngarkim të tij mbi



deklarimet e të gjykuarit A.Coli, i cili gëzon statusin e bashkëpunëtorit të drejtësisë.

30. Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë gjatë shqyrtimit të çështjes, konkretisht në faqen 408 të vendimit, është shprehur se “*në gjykimin në shkallë të parë, ndonëse të gjykuarit dhe mbrojtësit e tyre kanë nënshkruar procesverbalin për njohjen me aktet e betimit paraprak, mbi pretendimin e mbrojtësve gjykata ka urdhëruar përfaqësuesit e akuzës që të njohin mbrojtësit edhe me akte të fashikullit të prokurorit, që nuk janë pjesë e fashikullit të gjykimit?*”.

31. Gjykata vlerëson se në këto kushte nga vetë gjykatat është shmangur parregullsia, duke korrigjuar kështu të metat dhe shkeljet e evidentuara gjatë hetimit paraprak. Për rrjedhojë, edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar dhe nuk duhet të pranohet.

32. Edhe për sa i përket pretendimit të kërkuesit për pavlefshmërinë e thënieve të bashkëpunëtorit të drejtësisë A.C. në këtë proces gjyqësor, Gjykata vlerëson se nuk qëndron.

33. Gjykata vlerëson se ndryshe sa pretendohet nga kërkuesi, duke iu referuar dosjes objekt shqyrtimi, gjykatat e faktit kanë zbatuar drejt kërkesat e ligjit procedural penal.

34. Gjykata vlerëson se këto deklarime janë mbështetur dhe konfirmuar edhe me prova të tjera, siç janë provat shkresore, provat shkencore, ato me dëshmitarë etj.

35. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim është haptazi i pabazuar dhe nuk duhet të pranohet.

D. Për pretendimin e prezumimit të pafajësisë

36. Kërkuesi pretendon cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë nga gjykatat, pasi ato e kanë paragjykuar kërkuesin, pa u shpallur fajtor, si autor të veprës penale.

37. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë është një nga elementet përbërëse të procesit të rregullt ligjor. Ky parim parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit “kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë”. Gjykata është shprehur edhe më parë se parimi i prezumimit të pafajësisë do të thotë që gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet, se barra e provës i takon palës akuzuese, se çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe se gjykata duhet ta mbështesë

vendimin në prova direkte dhe indirekte që duhet të provohen nga akuzat (*shih vendimin nr.9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Edhe Gjykata Europiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) është shprehur se prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Është detyrë e prokurorit të informojë të akuzuarin për çështjen kundër tij, në mënyrë që ai të mund të përgatisë e paraqesë mbrojtjen dhe të kundërshtojë provat, të cilat mjaftojnë për ta dënuar atë. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal, mjafton të ekzistojë një arsyetim, i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja (*shih vendimet Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001 të GJEDNJ-së*).

39. Në rastin në shqyrtim, nga vlerësimi në tërësi i materialeve të paraqitura, Gjykata çmon se nuk rezulton asnjë e dhënë, e cila të tregojë se gjykatat e zakonshme, që kanë shqyrtuar çështjen, e kanë filluar procesin me paragjykimin se kërkuesi e ka kryer veprën penale apo e kanë konsideruar të akuzuarin fajtor para dhënies së një vendimi përfundimtar për fajësinë e tij. Gjithashtu, Gjykata vlerëson se nuk rezulton që gjykatat e zakonshme të kenë kaluar gjatë procesit barrën e provës nga prokurori tek i pandehuri. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar në argumente.

DH. Për pretendimin e cenimit të standardit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm

40. Kërkuesi ka pretenduar se gjatë gjykimit të çështjes në ngarkim të tij nuk është respektuar një nga të drejtat themelore kushtetuese që buron nga neni 42/2 i Kushtetutës, e drejta e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm.

41. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se ky standard duhet të vlerësohet mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës arsyeja e kohëzgjatjes së



procesit gjyqësor duhet të vlerësohet nën dritën e rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos kompleksitetin e çështjes, sjelljen e kërkuarit, sjelljen e autoriteteve, si dhe rrezikun që passjell për kërkuarin kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr.18, datë 19.07.2005; nr.1, datë 19.01.2009; nr. 69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, Gjykata, për të vlerësuar nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, duhet të analizojë elementet e sipërcituara.

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

42. Lidhur me periudhën e kohës që duhet marrë në konsideratë, vërehet se:

Nga përmbajtja e vendimeve të gjykatave rezulton se kjo çështje ka qenë në gjykim në shkallë të parë nga data 17.06.2007 (data e ardhjes së çështjes për gjykim) deri në datën 16.01.2012 (datë në të cilën është dhënë vendimi përfundimtar).

ii. Kompleksiteti i çështjes

43. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr.14, datë 15.04.2010; nr.9, datë 14.02.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Çështja objekt gjykimi është e natyrës penale. Objekti i saj lidhet me disa vepra penale, që kanë dashur kohë të shqyrtohen. Nga vlerësimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore në shkallë të parë rezulton se prej datës së ardhjes së çështjes për gjykim, 17.06.2007, deri në ditën e dhënies së vendimit, 16.01.2012, janë zhvilluar 199 seanca gjyqësore, si dhe janë thërritur dhe pyetur me cilësinë e dëshmitarit dhjetëra shtetas me banime në vende të ndryshme të Shqipërisë, ndërkohë disa shtetas të tjerë me gjithë kërkimet konform legjislacionit në fuqi, nuk janë gjendur ose nuk jetojnë më. Po ashtu, rezulton se janë shqyrtuar dhe verifikuar një numër i konsiderueshëm aktesh apo provash shkresore, akte ekspertimi balistik, grafik etj.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuarit

45. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarit është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga aktet bashkëlidhur

kërkesës vërehet se kërkuari ka shfaqur interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nuk rezulton të jetë bërë shkak apo të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Megjithatë, rezulton se si pasojë e një numri shumë të madh të pandehurish në këtë proces një pjesë e konsiderueshme e seancave gjyqësore nuk janë zhvilluar ose janë ndërprerë për shkak të mosparaqitjes, largimit të një apo më shumë mbrojtësve apo edhe për kërkesa të konsideruara si të padrejta nga gjykata.

iv. Sjellja e autoriteteve

46. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë të tillë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme.

47. Gjykata ka vlerësuar se edhe në ato sisteme ligjore, të cilat zbatojnë parimin se iniciativat procedurale u takojnë palëve, përsëri gjykatat kanë detyrimin për të siguruar progresin e gjyqësor me shpejtësi të mjaftueshme (*shih vendimet nr.14, datë 15.04.2010; nr.8, datë 23.03.2010; nr.9, datë 01.04.2009; nr.1, datë 19.01.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

48. Gjykata konstaton se në çështjen objekt shqyrtimi, në të gjitha rastet e ankimit të të pandehurve, pjesë e atij procesi gjyqësor, në një gjykatë më të lartë për shkaqe ligjore që ato i kanë quajtur të drejta apo kundërt vendimeve të ndërmjetme, gjykata ka komunikuar rregullisht të drejtat që kanë palët për ankim. Rezulton se disa nga këto ankime, të cilat janë ankimuar në Gjykatën e Apelit për Krime të Rënda, janë lënë në fuqi nga kjo gjykatë dhe për pasojë edhe afati i paraburgimit nuk ka ecur.

49. Si rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e afatit të arsyeshëm është i pabazuar.

50. Nisur nga sa më lart, Gjykata, në përfundim të gjykimit, vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuari është e pabazuar.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Besnik Imeraj, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 38, datë 25.4.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar	i	Gjykatës Kushtetuese
Vitore Tusha	anëtare	e	“ “
Fatmir Hoxha	anëtar	i	“ “
Gani Dizdari	anëtar	i	“ “
Besnik Imeraj	anëtar	i	“ “
Fatos Lulo	anëtar	i	“ “
Vladimir Kristo	anëtar	i	“ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.03.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 9 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Floresha Kalemaj

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Teuta Mone, Besnik Brahimaj, Xhemal Kalemaj, Ledio Kalemaj, Endri Kalemaj

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimit nr.196, datë 16.02.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

BAZA LIGJORE: Nenet 42/2, 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (KENDNJ); nenet 27 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vladimir Kristo, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuases, që është shprehur për pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, Xhemal Kalemaj, Endri Kalemaj dhe Ledio Kalemaj, që kanë kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkuësja ka qenë e punësuar pranë Drejtorisë Rajonale Shëndetësore Fier për një periudhë rreth 27-vjeçare, duke kryer punë të ndryshme funksionale. Me urdhrin nr.3, datë 21.03.2001 është vendosur shkarkimi nga detyra e përgjegjëses së informacionit shëndetësor të kërkuases dhe emërimi i saj në pozicionin e ndihmës epidemiologes në shërbimin e sëmundjeve infektive pranë Qendrës Shëndetësore Portëz/Fier. Duke nisur nga kjo periudhë kërkuësja ka paraqitur disa raporte mjekësore për paaftësi të përkohshme në punë dhe marrëdhënia e punës ka vazhduar deri në datën 26.05.2011, kur ajo është larguar nga detyra me urdher të eprorit të saj.

2. Pas largimit nga puna kërkuësja i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me dy kërkesëpadi, respektivisht për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës, si dhe për të konstatuar diskriminimin e saj nga punëdhënësi. Të dyja këtë gjykime kanë përfunduar në favor të kërkuases.

3. Kërkuësja i është drejtuar përsëri Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier me kërkesëpadi me objekt konstatimin e faktit të paligjshmërisë të veprimeve të subjekteve të interesuara, që lidhen me përpilimin dhe lëshimin e një relacioni ku anulohet raporti mjekësor i datës 22.04.2011, si dhe detyrimin e tyre për dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror në shumën prej 6.835.665 lekësh.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.62-2016-746(196), datë 16.02.2016, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë si të pabazuar në prova dhe në ligj.

5. Kundër këtij vendimi kërkuësja ka paraqitur ankim, i cili është duke u shqyrtuar në Gjykatën e Apelit Vlorë.



II

6. **Kërkuesja** i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) duke pretenduar shfuqizimin e vendimit objekt kërkese, pasi i ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor në këto drejtime:

6.1 Konstatimi i cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshem.

6.2 Është cenuar parimi i paanshmërisë, sepse nuk është pranuar kërkesa për përjashtimin e avokatit, gjykata nuk u ka kthyer përgjigje të gjitha kërkimeve të palëve, ka gabuar në lidhje me legjitimitimin e ndërhyrësve dytësorë, ka marrë vendimin në mungesë të provave, ka gabuar në arsyetim lidhur me rrëzimin e aktit të ekspertimit, si dhe ka gabuar në lidhje me parimin e gjësë së gjykuar.

7. **Subjektet e interesuara**, Xhemal Kalemaj, Endri Kalemaj dhe Ledio Kalemaj, në cilësinë përkatësisht të bashkëshortit të kërkueses dhe fëmijëve të saj, të thirrur si ndërhyrës dytësorë në gjykimin e themelit, kanë parashtruar të njëjtat pretendime si ato të kërkueses.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkueses¹

8. Në kushtet kur vendimi objekt shqyrtimi nuk ka marrë formë të prerë Gjykata çmon se fillimisht duhet të analizohet çështja e legjitimitimit të kërkueses, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, lidhur me ekzistencën e një vendimi përfundimtar dhe shterimin e të gjitha mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përpara se individi t'i drejtohet kësaj Gjykate.

9. Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës, individi mund t'i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shterur të

gjitha mjetet juridike. Shterimi i mjeteve juridike nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimin nr.16, datë 10.03.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Gjykata ka theksuar se juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt bëhet i mundur kur kërkuesi të ketë shteruar mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuesi duhet t'i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr.39, datë 06.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin objekt shqyrtimi, nga materialet bashkëlidhur kërkesës, Gjykata vëren se vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier është ankimuar nga kërkuesja në Gjykatën e Apelit Vlorë, prandaj ai nuk mund të konsiderohet si një vendim përfundimtar për efektet e gjykimit kushtetues, pasi nuk vendos në mënyrë përfundimtare mbi objektin e kërkesës. Me fjalë të tjera, vendime të këtij lloji, për më tepër kur procesi i themelit vazhdon të jetë në gjykim, nuk mund të quhen përfundimtare në kuptim të nenit 131/f të Kushtetutës. Në këto rrethana Gjykata rithekson qëndrimin e mbajtur në jurisprudencën e saj se kërkuesja i ka të gjitha mjetet e nevojshme juridike për mbrojtjen e interesave të saj gjatë rigjyimit të çështjes, përfshirë më pas edhe mbrojtjen kushtetuese pranë kësaj Gjykate.

12. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses se legjitimohet t'i drejtohet kësaj Gjykate, mbështetur në argumentin se GJEDNJ-ja ka konstatuar se mjete më i mirë i ankimit është parandalimi, që në rastin konkret konsiston në faktin e mospërsëritjes së të njëjtave shkeljeve në Gjykatën e Apelit (ku çështja është duke u shqyrtuar), është haptazi i pabazuar.

13. Në këto kushte, Gjykata çmon se kërkuesja nuk legjitimohet për të vënë në lëvizje gjykimin

¹ Gjyqtare V.Tusha votoi për moslegjitimitimin e kërkueses për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke rikonfirmuar qëndrimin e shprehur edhe më parë në çështje të kësaj natyre, në kushtet kur çështja e iniciuar prej saj është ende në shqyrtim në sistemin gjyqësor dhe nuk është dhënë një vendim përfundimtar nga gjykata.



kushtetues lidhur me themelin e pretendimeve të saj. Për rrjedhojë, Gjykata në vijim do të shqyrtojë vetëm pretendimin për konstatimin e cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor për shkak të mosgjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm.

B. Për pretendimin për mosgjykimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

14. Gjykata në praktikën e saj ka theksuar se në bazë të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, individit legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, duke pretenduar cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm gjatë zhvillimit të procesit të gjykimit nga gjykata e zakonshme, për shkak se legjislacioni nuk parashikon mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimin nr.81, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszhvillimit të gjykimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ka theksuar se vlerësimi duhet të bëhet rast pas rasti mbi bazën e kritereve të përcaktuara në jurisprudencën e GJEDNJ-së, duke iu referuar rrethanave të veçanta të çështjes, dhe sidomos kompleksitetit të çështjes, sjelljes së kërkuarit, sjelljes së autoriteteve, si dhe rrezikut që passjell për kërkuarin kjo te zgjatje e afateve të gjykimit (*shih vendimin nr.81, datë 28.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*). Për rrjedhojë, për të arritur në një përfundim nëse në rastin konkret jemi përpara cenimit të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e moszekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, Gjykata çmon se duhet të vlerësohen elementet e mëposhtme:

i. Periudha që duhet marrë në konsideratë

16. Lidhur me pretendimin për zgjatjen e procesit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier tej afatit të arsyeshëm, Gjykata vëren se kjo e fundit e ka filluar shqyrtimin e çështjes në datën 10.06.2014 dhe e ka përfunduar atë në datën 16.02.2016, pra për një periudhë kohore prej 1 viti e 8 muajsh.

ii. Kompleksiteti i çështjes

17. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve kanë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshi objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkrësore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë

kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Në rastin në shqyrtim Gjykata konstaton se gjykimi i iniciuar prej kërkuarës ka për objekt konstatimin e faktit të paligjshmërisë së veprimeve të subjekteve të interesuara dhe për pasojë dëmshpërblimin e dëmit pasuror dhe jopasuror në favor të kërkuarës. Edhe pse gjatë gjykimit janë shfaqur disa probleme juridike, si ai lidhur me legjitimitimin e avokatëve të subjekteve të interesuara, të cilat kanë kushtëzuar disa seanca, Gjykata çmon se ky fakt nuk justifikon një te zgjatje të procesit dhe se në këtë drejtim çështja nuk paraqitet me natyrë komplekse.

iii. Interesi dhe sjellja e kërkuarës

19. Vlerësimi i sjelljes dhe interesit të kërkuarës është një element tjetër përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve. Nga materialet e çështjes referuar kronologjisë së seancave, Gjykata vëren se seancat e datave 10.09.2014, 09.12.2014 dhe 06.05.2015, janë shtyrë për shkaqe që i ngarkoheshin kërkuarës apo për mosparaqitje të saj (seanca e datës 09.12.2014). Edhe pse këto shkaqe lidhen me përmbushjen dhe ushtrimin e të drejtave të saj procedurale, të parashikuara nga KPC-ja, si parashtrimi i disa provave të reja apo kërkesa për shtim të objektit të padisë, Gjykata vëren se ato kanë ndikuar në vonesa të pajustificuara për zhvillimin e gjykimit.

iv. Sjellja e autoriteteve

20. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë standardet për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme. Kjo detyrë e gjykatave gjen rregullimin e saj edhe në dispozitat procedurale civile, e konkretisht në nenin 4 të KPC-së, sipas të cilit: “Gjykata kujdeset për zhvillimin e rregullt të procesit gjyqësor. Për këtë qëllim, në bazë të kompetencave që i jep ky Kod, vendos për afatet dhe urdhëron marrjen e masave të nevojshme” dhe në nenin 171/a të KPC-së, sipas të cilit: “Gjykata ushtron të gjitha të drejtat e përcaktuara në këtë Kod, që janë të nevojshme për zhvillimin sa më të mirë të procesit gjyqësor. Gjykata cakton seancat dhe afatet brenda të cilave palët dhe personat e tjerë të thirrur prej saj



dubet të kryejnë aktet procedurale dhe veprimet e tjera të kërkuara prej saj” (shih vendimin nr.69, datë 17.11.2015 të Gjykatës Kushtetuese).

21. Gjykata ka theksuar gjithashtu se për sa i përket sjelljes së autoriteteve, edhe pse kuadri procedural civil ka parashikuar parimin se nismat procedurale u takojnë palëve², kjo nuk i shkarkon gjykatat nga detyrimi për të siguruar një gjykim të shpejtë, siç kërkon neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6/1 i KEDNJ-së (shih vendimin nr.45, datë 19.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

22. Në rastin në shqyrtim, nga materialet e ndodhura në dosje, Gjykata vëren se nga dita e paraqitjes së kërkesëpadisë deri në dhënien e vendimit janë zhvilluar 26 seanca. Hapësira kohore e seancave nga njëra-tjetra është mesatarisht 3-4 javë. Duke iu referuar shkaqeve të shtyrjes së seancave, Gjykata konstaton se dy seanca (të datave 26.06.2014 dhe 16.07.2014) janë shtyrë për mosparaqitje të avokatit të subjekteve të interesuara, dy seanca (11.11.2014 dhe 15.01.2015) për mosparaqitje të vetë subjekteve të interesuara dhe një seancë për mosparaqitje të palës paditëse (09.12.2014). Dy seanca të tjera (15.10.2015 dhe 10.12.2015) janë shtyrë për mosformim të justifikuar të trupit gjykues dhe pesë seanca (12.02.2015, 11.03.2015, 08.04.2015, 06.05.2015 dhe 04.06.2015) për paraqitje të prapësimeve të subjekteve të interesuara. Nisur nga këto të dhëna të çështjes, Gjykata vlerëson se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier nuk është bërë pengesë për zhvillimin e gjykimit.

23. Lidhur me këto fakte kërkuesja i është drejtuar edhe Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka marrë në shqyrtim pretendimet e kërkueses duke konstatuar se *prima facie* ka pasur zvarritje të gjykimit nga ana e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe se përfundimi i gjykimit të çështjes në fjalë është bërë tej afatit maksimal të gjykimit.

24. Nga ana tjetër, Gjykata, edhe në vështrim të jurisprudencës së GJEDNJ-së, lidhur me interpretimin e nenit 13 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, gjen me vend të ritheksojë se një ndër kriteret që duhet të plotësojë një ankim për të qenë efektiv është që mjeti të ofrojë mundësi të qarta dhe të sigurta për rivendosjen në vend të së drejtës së pretenduar. Ajo ka përcaktuar, gjithashtu, se mjeti që të jetë efektiv duhet të jetë i

përshtatshëm, i disponueshëm dhe efikas për një çështje konkrete (shih vendimin nr.43, datë 12.07.2016 të Gjykatës Kushtetuese).

25. Në këtë drejtim, GJEDNJ-ja e ka trajtuar çështjen e efektivitetit të mjetit të ankimit në një perspektivë më të gjerë, duke dhënë disa orientime lidhur me karakteristikat që duhet të ketë një mjet i brendshëm ankimi. GJEDNJ-ja ka konstatuar se mjeti më i mirë i ankimit, si në çdo fushë tjetër, është pa dyshim parandalimi. Ajo ka mbajtur në mënyrë të përsëritur qëndrimin se neni 6/1 imponon mbi shtetet kontraktuese detyrimin për t'i organizuar sistemet e tyre gjyqësore në atë mënyrë që gjykatat të mund të përmbushin secilën nga kërkesat e tij, veçanërisht për sa i përket afatit të arsyeshëm (shih, ndër të tjera, *Süßmann kundër Gjermanisë nr.20024/92 pg.55*). Kur sistemi gjyqësor ka mangësi në këtë drejtim, një mjet i projektuar për të përshpejtuar procedurat, me qëllim parandalimin e kohëzgjatjes së tepërt të procesit, përbën zgjidhjen më efektive. GJEDNJ-ja në shumë raste i ka njohur këtij lloji ankimi një karakter efektiv në masën që ai lejon përshpejtimin e vendimit gjyqësor në fjalë (shih ndër të tjera *Luli kundër Shqipërisë, nr.64480/09, 64482/09, 12874/10, 56935/10, 3129/12 dhe 31355/09, Scordino kundër Italisë nr.36813/97 pg. 184, Bacchini kundër Zvicrës nr.62915/00, Tomé Mota kundër Portugalisë nr.32082/96*).

26. Nga sa më lart, nga analiza e secilit prej elementeve që ndikojnë në moszhvillimin e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vlerëson se në rastin në shqyrtim duhet pasur parasysh jo vetëm kohëzgjatja e procesit, por edhe veprimet aktive të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe fakti që edhe vetë kërkuesja apo avokatët e palëve disa herë janë bërë shkak për zvarritjen e procesit. Në këto kushte, nisur edhe nga rrethana se gjykimi në shkallë të parë ka përfunduar, ndërhyrja e kësaj Gjykate nuk do të sillte asnjë pasojë në drejtim të efektivitetit të vendimmarrjes së saj.

27. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, për shkak se çështja në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier nuk është gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, është i papabazuar dhe duhet rrëzuar.

² Neni 2 i Kodit të Procedurës Civile.



PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131/f dhe nenit 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vitore Tusha, Besnik Imeraj, Gani Dizdari, Vladimir Kristo, Fatos Lulo

VENDIM

Nr. 39, datë 5.5.2017

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Besnik Imeraj	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“

me sekretare Belma Lleshi, në datën 16.03.2017 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 7 Akti, që u përket:

KËRKUES: KASTRIOT PASHOLLARI, FERUZE PASHOLLARI

SUBJEKT I INTERESUAR: Ministria e Mbrojtjes

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 2779, datë 07.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; nr.2088, datë 13.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë; 00-2014-3005, datë 06.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 4, 42, 131/f dhe 134/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e

Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet me shkrim të subjektit të interesuar, Ministrisë së Mbrojtjes, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Kërkesit janë prindërit e shtetasit G.P., i cili ka humbur jetën gjatë kryerjes së shërbimit ushtarak të detyrueshëm. Sipas librezës së lëshuar nga Dega Ushtarake e Rrethit Përmet e datës 01.06.1992 rezulton se ai ka qenë i aftë për të kryer shërbimin ushtarak. Kërkesit, duke pretenduar se djali i tyre ishte diagnostikuar që i vogël me një sëmundje që e bënte të paaftë për të kryer shërbimin ushtarak, e cila ka qenë një nga arsyet që nuk i mbijetoi goditjes me armë zjarri, pavarësisht ndihmës mjekësore të dhënë, i janë drejtuar gjykatës me padi duke kërkuar konstatimin e pavlefshmërisë së librezës ushtarake të lëshuar për shtetasin G.P., si dhe shpërblimin, nga pala e paditur, Ministria e Mbrojtjes, të dëmit jopasuror për humbjen e jetës së tij, si pasojë e thirrjes në shërbimin ushtarak të detyrueshëm.

2. Me vendimin nr.2779, datë 07.04.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë.

3. Me vendimin nr.2088, datë 13.10.2011, Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm të gjykatës së shkallës së parë. Kundër këtij vendimi kërkesit kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë.

4. Me vendimin nr.00-2014-3005, datë 06.11.2014, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur.

II

5. **Kërkesit Kastriot dhe Feruze Pashollari** i janë drejtuar me kërkesë Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) për shfuqizimin e vendimeve objekt kërkesë, duke paraqitur këto shkaqe në mënyrë të përmbledhur:



5.1 Kërkesit janë vënë në dijeni me shkresën e datës 29.01.2007 se personat që vuajnë nga sëmundja nga e cila vuante edhe djali i tyre nuk rekrutohen për shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Referuar këtij momenti dhe datës së paraqitjes së kërkesëpadisë (16.01.2009), rezulton se ajo është ngritur brenda afatit ligjor. Argumenti i gjykatës për parashkrimin e padisë nuk qëndron, pasi vlerësimi i faktit se viktima ishte i aftë për të kryer shërbimin ushtarak ishte bërë nga një komision mjekësor.

5.2 Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim, për shkak të shkeljeve procedurale të lejuara në Gjykatën e Apelit Tiranë me pasojë gjykimin në mungesë të kërkesve.

5.3. Është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe gjykuar në Gjykatën e Lartë, si rezultat i mospranimit të rekursit në dhomë këshillimi, i cili mbështetej në shkaqe që lejojnë kalimin dhe shqyrtimin e tij në seancë plenare.

5.4 Është cenuar standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor, pasi në vendimin e Kolegjit Administrativ mungojnë shkaqet e mospranimit të rekursit.

6. **Subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes**, në prapësimet me shkrim drejtuar Gjykatës, në mënyrë të përmbledhur ka parashtruar sa vijon:

6.1 Pretendimet e kërkesve të nivelit kushtetues vetëm sa janë përmendur si të tilla, pa u argumentuar dhe arsyetuar se ku dhe si janë kryer këto shkelje. Në kërkesë janë ngritur vetëm pretendime që kanë të bëjnë me mënyrën e zbatimit dhe interpretimit të ligjit nga ana e gjykatave të zakonshme, çka nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues, për rrjedhojë kërkesit nuk legjitimohen *ratione materiae*.

6.2 Pretendimi për cenimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe parimit të barazisë së armëve është i pabazuar, pasi Gjykata e Apelit e ka zhvilluar procesin në përputhje me përcaktimet e KPC-së, duke proceduar me shpallje publike. Kjo gjykatë nuk ka detyrim ligjor për njoftimin e palëve, për sa kohë që ligji parashikon zhvillimin e gjykimit edhe pa praninë e tyre.

6.3 I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Për këtë pretendim kërkesit kanë dhënë vetëm konsiderata të përgjithshme dhe argumentojnë se Gjykata e Lartë duhet të rregullonte shkeljet e kryera nga gjykatat më të ulëta, por pa referuar konkretisht se cilat janë këto

shkelje. Vendimi i Gjykatës së Lartë është i rregullt në formë dhe përmbajtje, ka trajtuar çështjet e ngritura në recurs, ka dhënë argumente të bazuara në dispozitat ligjore mbi vendimmarrjen, si dhe arsyet pse duhet të lihen në fuqi vendimet e gjykatave më të ulëta. Ky vendim plotëson kërkesat që kërkon standardi i arsyetimit në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesve

7. Gjykata vlerëson se kërkesit legjitimohen *ratione personae* në lidhje me pretendimet e paraqitura në kërkesë, në kuptim të nenit 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga ligji nr.8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë". Vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 06.11.2014, kurse zarfi me të cilin është dërguar kërkesa në Gjykatë është i datës 05.11.2016.

8. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae* të kërkesve, në jurisprudencë të vazhdueshme Gjykata ka theksuar se interpretimi i ligjit, zbatimi i tij në çështjet konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Kontrolli kushtetues që kjo Gjykatë ushtron ndaj vendimeve gjyqësore është i kufizuar vetëm në funksion të mbrojtjes së të drejtave kushtetuese të individit për një proces të rregullt ligjor. Problemet e interpretimit dhe të zbatimit të ligjit për zgjidhjen e çështjeve konkrete nuk përbëjnë juridiksion kushtetues, nëse ato nuk shoqërohen me cenimin e këtyre të drejtave (*shih vendimin nr.3, datë 19.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Bazuar në këto standarde Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkesve në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga Gjykata e Apelit Tiranë, konkretisht në lidhje me afatin e parashkrimit të padisë, janë çështje që kanë të bëjnë me mënyrën e vlerësimit të provave dhe interpretimit të ligjit nga ana e asaj gjykate. Duke qenë çështje që i përkasin juridiksionit të zakonshëm gjyqësor, zgjidhja e tyre nuk përfshihet në juridiksionin kushtetues. Për rrjedhojë, kërkesit nuk legjitimohen *ratione materiae* në lidhje me këto pretendime.



10. Në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në kërkesë, Gjykata vlerëson se ato *prima facie* janë të tilla që bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit në gjykim

11. Sipas kërkesve ata nuk janë njoftuar për seancën gjyqësore të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe çështja është gjykuar në mungesë të tyre, për rrjedhojë është cenuar e drejta për t'u dëgjuar dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim.

12. Në lidhje me këtë pretendim subjekti i interesuar, Ministria e Mbrojtjes, ka prapësuar se Gjykata e Apelit e ka zhvilluar procesin në përputhje me përcaktimet e KPC-së, duke proceduar me shpallje publike. Sipas tij, kjo gjykatë nuk ka detyrim ligjor për njoftimin e palëve, për sa kohë që ligji parashikon zhvillimin e gjykimit edhe pa praninë e tyre.

13. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr.37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes palëve. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi

të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të mbizotëronin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve apo përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr.37, datë 30.06.2016 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht, në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrtojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr.5, datë 02.03.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga aktet e dosjes gjyqësore të administruar për efekte të këtij gjykimi, rezulton se pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë kërkesit kanë paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë. Kjo e fundit, me shkresën e datës 03.05.2010, ka njoftuar kërkesit në rrugë administrative se ankimi nuk plotëson kriteret e nenit 454/c të KPC-së dhe u ka lënë një afat 5-ditor për plotësimin e të metave. Po nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se në Gjykatën e Apelit Tiranë çështja e kërkesve është regjistruar në datën 30.07.2010. Me shkresën e datës 28.09.2011 gjyqtari i çështjes u ka dërguar kërkesve njoftim për plotësimin e të metave të ankimit, i cili rezulton t'i jetë njoftuar përfaqësuesit të kërkesve në datën 03.10.2011. Ky i fundit në datën 06.11.2011 ka paraqitur në gjykatë një ankim shtesë. Shqyrtimi i kësaj çështjeje në Gjykatën e



Apelit është bërë në datën 13.10.2011 dhe nga procesverbalit i seancës gjyqësore nuk rezulton të jenë paraqitur në gjykim kërkesit dhe përfaqësuesi i tyre, për rrjedhojë gjykata ka vazhduar me gjykimin në mungesë. Në përfundim të kësaj seance Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

17. Gjykata vëren se në lidhje me njoftimin për ditën dhe orën e gjykimit neni 460 i KPC-së ka parashikuar se ai bëhet nga gjykata e apelit me shpallje pranë saj dhe në gjykatat përkatëse të shkallës së parë. Sipas nenit 461 të po këtij Kodi, mosparaqitja e palëve, për të cilat njoftimi është bërë me shpallje, nuk pengon shqyrtimin e çështjes, me përjashtim të rastit kur janë njoftuar shkaqe të arsyeshme për mungesën. Po sipas kësaj dispozite, gjykata nuk mund ta shqyrtojë çështjen në mungesë atëherë kur dëgjimi i palëve është një nga detyrat e rigjyimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore, vëren se nuk është administruar asnjë akt në lidhje me mënyrën dhe datën e njoftimit të palëve për seancën gjyqësore të datës 03.10.2011 në Gjykatën e Apelit Tiranë. Gjykata vëren, gjithashtu, se sipas procesverbalit të seancës gjyqësore të datës 13.10.2011 shkak për gjykimin në mungesë të palës paditëse është se ajo ka dijeni me fletëthirrje sipas ligjit dhe nuk është paraqitur në gjykim pa shkaqe të arsyeshme, ndërkohë që fletëthirret të cilave u referohet Gjykata e Apelit jo vetëm që nuk janë të administruara në fashikullin gjyqësor të asaj gjykate, por as nuk përmenden në listën e dokumenteve (inventarin) të dosjes gjyqësore. Po ashtu, me shkresën e datës 14.02.2017, Gjykata i ka kërkuar asaj informacion në lidhje me mënyrën e njoftimit të palëve për këtë seancë gjyqësore. Gjykata e Apelit Tiranë, me shkresën e datës 15.03.2017, ka informuar Gjykatën se sipas verifikimit të sistemit për çështjen gjyqësore në shqyrtim është zhvilluar një seancë gjyqësore dhe se aktet e njoftimit të palëve administrohen në dosjen gjyqësore. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se mospjesëmarrja e kërkesve në gjykim ka ardhur si pasojë e mosrespektimit nga ana e Gjykatës së Apelit Tiranë të detyrimit për njoftimin e rregullt të palëve në procesin gjyqësor. Në vështrim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se procesi i zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë është i parregullt nga pikëpamja kushtetuese, për rrjedhojë vendimi i kësaj gjykate duhet të shfuqizohet.

18. Gjykata vëren se kërkesit e kanë ngritur këtë pretendim edhe në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë. Ata kanë pretenduar se në gjykimin në apel ka pasur shkelje të dispozitave procedurale, për shkak se çështja është gjykuar pa u shpallur data e seancës gjyqësore. Megjithatë, ky pretendim nuk rezulton të jetë pasqyruar në vendimin e Kolegjit Administrativ, ndërkohë që në të janë pasqyruar vetëm disa shkaqe që kanë të bëjnë me themelin e çështjes. Kurse në arsyetimin e vendimit të mospranimit, Kolegji Administrativ shprehet se “nga aktet procedurale të gjyimit të zhvilluar konstatohet se palëve iu është dhënë mundësia të paraqesin prova, të njihen me provat e palës kundërshtare, ato kanë debatuar rreth provave, duke shprehur opinionin e tyre në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes, pa u vënë në kushte pabarazie dhe pa u mohuar ndonjë e drejtë që lidhet me cenimin e së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur.”.

19. Gjykata rithekson se kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, për më tepër i Gjykatës së Lartë. Ky raport ndërmjet juridiksionit kushtetues dhe juridiksionit të gjykatave të zakonshme, kur është rasti i shqyrtimit nga ana e Gjykatës Kushtetuese të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit (komplementaritetit) (*shih vendimin nr.62, datë 23.09.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

20. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Në këtë kuptim, Gjykata e vlerëson si cenim të parimit për një proces të rregullt ligjor kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk plotëson apo nuk korrigjon mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe elementeve të një procesi të rregullt ligjor.

21. Gjykata, në vështrim të standardeve të mësipërme, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se parregullsitë e konstatuara prej saj në lidhje me njoftimin e palëve gjatë gjyimit të zhvilluar në Gjykatën e Apelit Tiranë nuk janë riparuar nga Gjykata e Lartë, vlerëson se edhe vendimi i Kolegjit Administrativ u ka cenuar kërkesve të drejtën kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit 42 të



Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, për rrjedhojë duhet të shfuqizohet.

22. Në përfundim, Gjykata vlerëson se pretendimet e kërkuesve për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor janë të bazuara dhe kërkesa duhet të pranohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1/i të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 e vijues të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

- Pranimin pjesërisht të kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimeve nr.2088, datë 13.10.2011 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe 00-2014-3005, datë 06.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.³
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Apelit Tiranë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Fatmir Hoxha, Vladimir Kristo, Vitore Tusha, Fatos Lulo, Besnik Imeraj

³ Gjyqtari V. Kristo ka votuar për pranimin e kërkesës vetëm për shfuqizimin e vendimit nr.00-2014-3005, datë 06.11.2014 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 168 lekë